



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. <u>01-2513/14</u>
Dep. <u>02</u>	Br. Prot. <u>01-2513/14</u>
Nr. i faq. <u>02</u>	Prot No <u>01-2513/14</u>
Broj stranica <u>02</u>	Data <u>04-07-2014</u>
Nr. pages <u>02</u>	Datum <u>04-07-2014</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	04/07/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Fadil ABAZI Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Vitisë
CC:	z. Sokol HALITI Kryetar i Komunës së Vitisë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në fshatrat Trestenik dhe Sodovinë e Çerkezëve



I nderuari z. ABAZI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në fshatrat Trestenik dhe Sodovinë e Çerkezëve me numër prokurimi: VI657-14-034-521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në fshatrat Trestenik dhe Sodovinë e Çerkezëve me numër prokurimi: VI657-14-034-521 në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.



## A r s y e t i m

Komuna e Vitisë, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në fshatrat Trestenik dhe Sodovinë e Çerkezëve” me numër të prokurimit:VI657-14-034-521. Ky aktivitet prokurimi më datë:17/06/2014 është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të këtij aktiviteti nga “Dosja e Tenderit”, Agjencia ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), tek Kërkesat e përshtatshmërisë pika 7.2, nënpika 2, thuhet: *Bartësi kryesor i konzorciumit lideri, duhet të plotësoj 60 % të kritereve ekonomike-financiare-teknike dhe profesionale.* Kërkesat që kanë të bëjnë me Gjendjen Ekonomike dhe Financiare, si dhe Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale duhet të plotësohen nga Grupi i Operatorëve në tërësi, e jo nga secili Operator Ekonomik veç e veç, siç është kërkuar në “Dosja e Tenderit”. Autoriteti Kontraktues gjithashtu nuk ka të drejtë ti përcaktojë Operatorit Ekonomik përqindjen se sa për qind mund ta plotësoj njëri tjetrin.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 8.1 nënpika 1, thuhet: *Vlera e përgjithshme monetare e punëve të ekzekutuara në lëmin e kanalizimeve dhe të ngjashme, për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik të jetë në vlerë prej 400.000.00 €.* Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj qarkullim financiar për tre vitet e fundit shumë të caktuar, e cila nuk duhet të kaloj dy herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit; Nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; si dhe Neni 5, Gjendja Ekonomike dhe Financiare i UA-02/2014.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

